



**Agjencia për shërbime mediatike
Audio dhe audiovizuele**

Programi i punës për vitin 2022

PËRMBAJTJA

HYRJE	3
1. MBIKËQYERJE MBI TRANSMETUESIT	4
1.1. DETYRIMET PROGRAMORE TË TRANSMETUESËVE	4
1.2. DETYRIME TË TJERA TË TRANSMETUESËVE	5
1.3. FUNKSIONIMI PUBLIK I TRANSMETUESËVE	5
1.4. MBROJTJA E PLURALIZMIT TË PRONËSISË SË TRANSMETUESËVE	6
1.5. MBIKËQYERJE PROFESIONALE	7
2. PËRFSHIRJA SHOQËRORE DHE ARSIMIMI MEDIATIK	7
3. INKURAJIMI I LIRISË SË SHPREHJES DHE LIRISË SË MEDIAS	8
4. DHËNIA E LICENCAVE PËR TELEVISION OSE RADIO TRANSMETUES	9
5. MBIKËQYRJE MBI OFRUESIT E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIOVIZUELE SIPAS KËRKESËS	10
6. MBIKËQYRJE E OPERATORËVE TË RRJETEVE PUBLIKE TË KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK	11
7. MBIKËQYRJE MBI BOTUESIT E MEDIAVE TË SHKRUARA	12
8. ANALIZA DHE HULUMTIME	13
9. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR	15
10. PROCESI I INTEGRIMIT EVROPIAN	16
11. TRANSPARENCA NË PUNË DHE KOMUNIKIMIN ME PUBLIKUN	17
12. NGRITJA E KAPACITETEVE INSTITUCIONALE TË AGJENCISË	19
13. REVIZIONI I BRENDSHËM NË AGJENCI	20

HYRJE

Programi i punës së Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale për vitin 2022 është përgatitur në bazë të obligimit neni 8 i ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale dhe përcakton aktivitetet që Agjencia planifikon t'i ndërmarrë këtë vit, në përputhje me kompetencat e tij ligjore. Si organ kompetent për zbatimin e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, arritja e qëllimeve të Agjencisë duhet të kontribuojë në arritjen e qëllimeve të përgjithshme që duhet të arrihen me zbatimin e këtij ligji, përkatësisht: zhvillimi i shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale; promovimi i lirisë së shprehjes; zhvillimi i produksionit të pavarur; inkurajimi, promovimi dhe mbrojtjen e identitetit kulturor, gjuhës dhe traditës së komuniteteve në Republikën e Maqedonisë, respektimi i dallimeve kulturore dhe fetare, nxitja e kulturës së dialogut publik ndërmjet qytetarëve me qëllim për të forcuar mirëkuptimin dhe tolerancën reciproke për promovimin e marrëdhënieve ndërmjet komuniteteve të ndryshme, nxitjen e kreativitetit, zhvillimit arsimor dhe shkencor; mbrojtjen e interesave të shfrytëzuesve, në veçanti të të miturve; zhvillimi i arsimit mediatik; transparent i pavarur, efikas dhe i përgjegjshëm dhe servis transmetues; transparent, i pavarur, efikas dhe i përgjegjshëm organ rregullator në fushën e shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale; zhvillim tekniko-teknologjik i shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale, konvergjenca me shërbimet e komunikimit elektronik dhe shoqërisë së informacionit; nxitja dhe zhvillimi i konkurrencës në shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale dhe ritransmetimi i shërbimeve programore përmes rrjeteve publike të komunikimit elektronik dhe zhvillimi i ekonomisë maqedonase.

Gjatë vitit 2022, Agjencia do të ndjek përmbushjen e detyrimeve programore të transmetuesve, si dhe detyrimet e tjera të përcaktuara për ta në Ligjin për media dhe në aktet nënligjore që dalin nga këto dy ligje. Përveç kësaj Agjencia do të ndërmarrë aktivitete në drejtim që synojnë mbrojtjen e pluralizmit të pronës së transmetuesve, nxitja e përfshirjes sociale dhe arsimit mediatik, nxitja e lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave. Në kuadër të kompetencave të saj, do të mbikëqyrë funksionimin e ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës, rrjeteve publike të komunikimit elektronik dhe botuesve të medias së shkruar. Në planin ndërkombëtar, Agjencia do të vazhdojë të marrë pjesë aktive në takimet e organizatave dhe asociacioneve ndërkombëtare në të cilën është anëtare ose ka status vëzhguesi, por edhe në ngjarje të tjera me karakter ndërkombëtar të rëndësishme për fushën audiovizuale, dhe të sigurojë transparencë në punën e saj, Agjencia dhe në vitin 2022 do të organizojë takime publike në të informuar publikun dhe median për aktivitetet e ndërmarra në fushënveprimin e saj të punës dhe për të cilat do të diskutohet për çështje të ndryshme në fushën audio dhe audiovizuale.

1. MBIKËQYRJA NDAJ TRANSMETUESVE

1.1. DETYRIMET PROGRAMORE TË TRANSMETUESVE

Agjencia do të ndjek përmbushjen e obligimeve programore të transmetuesve duke kryer mbikëqyrje programore mbi shërbimet radiotelvizive të Radiodufuzionit Publik, shoqëritë transmetuese komerciale dhe institucionet transmetuese jofitimprurëse. Mbikëqyrja programore do të kryhet si e rregullt (sipas planit vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes programore për vitin 2022), e jashtëzakonshme (në bazë të iniciativës së paraqitur nga organet shtetërore, persona juridikë ose fizikë, si dhe në rast dyshimi sipas detyrës zyrtare të Agjencisë.) dhe kontrollin (pas skadimit të afatit të përcaktuar në masën e shqiptuar), dhe në përputhje me „Metodologjinë për kryerjen e mbikëqyrjes së programit (monitorimit)“. Detyrimet programore që do t'i nënshtrohen mbikëqyrjes i referohen:

- ✦ Standardeve të të drejtave të njeriut dhe Parimet e transmetimit të programeve;
- ✦ Mbrojtja e të miturve ;
- ✦ Nxitja dhe mbrojtja e identitetit kulturor;
- ✦ Rregullat për transmetimin e komunikimeve komerciale;
- ✦ Koncepti i programit për të cilin është dhënë licenca e transmetimit;
- ✦ Ngjarje me të drejta ekskluzive dhe të drejtën për raportim të shkurtër; dhe
- ✦ Detyrimet të tjera programore (transmetim kuize dhe programe të tjera që premtojnë shpërblime; kohëzgjatja minimale e transmetimit ditor; përdorimi i shërbimeve telefonike me vlerë të shtuar dhe votimi telefonik në programe; transmetimi i lojërave të fatit; lidhje me një sistem të vetëm për transmetimin e një programi të përbashkët, etj.).

Qëllimi: Rritja e respektimit të obligimeve programore nga Ligji për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale, licencat për transmetim radioteleviziv, aktet nënligjore dhe aktet tjera të miratuara nga Agjencia.

Aktivitetet:

✦ **Mbikëqyrja programore mbi programet e transmetuesve në përputhje me**

Metodologjinë e kryerjes së mbikëqyrjes së programit (monitorim)

Periudha e realizimit: Gjatë vitit

Rezultati: Raportet me shkrim nga mbikëqyrjet e kryera programore

1.2. DETYRIMET TJERA TË TRANSMETUESVE

Agjencia do të kryejë edhe mbikëqyrje administrative për të siguruar përmbushjen e obligimeve të tjera të transmetuesve të përcaktuara në Ligjin për shërbimet mediatike audi dhe audiovizuele dhe Ligjin për media. Objekt i kësaj mbikëqyrje do të jetë përmbushja e detyrimeve për publikimin e impresiumit, sigurimi i aksesit në informacionet që duhet të jenë në dispozicion të shfrytëzuesve, identifikimi i shërbimit programor, regjistrimet ditore të programit të transmetuar, regjistrimi i sinjalit dalës nga programi dhe dorëzimi i raportit për përmbushjen e konceptit programor. Kjo mbikëqyrje do të kryhet si e rregullt (në përputhjen e Planit vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes administrative në vitin 2022), të jashtëzakonshëm dhe kontrolluese. Gjatë vitit, Agjencia do të llogarisë tarifën vjetore për licencën për transmetim televiziv dhe radio emetim dhe do të monitorojë përmbushjen e detyrimit për pagesën e kësaj tarife nga transmetuesit.

Qëllimi: Rritja e respektimit të detyrimeve administrative të transmetuesve.

Aktivitetet:

✚ Mbikëqyrja administrative mbi funksionimin e transmetuesve

Periudha e realizimit: Gjatë vitit

Rezultati: Raportet me shkrim nga mbikëqyrjet administrative të kryera

1.3. FUNKSIONIMI PUBLIK I TRANSMETUESVE

Përmbushjen e obligimeve për funksionimin publik të transmetuesve në punën e transmetuesve, Agjencia do ta ndjek përmes mbikëqyrjes administrative, në përputhje me Planin vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes administrative në vitin 2022. Bëhet fjalë për detyrimet e përcaktuara në Ligjin për mediat, sipas të cilit transmetuesit janë të detyruar që jo më vonë deri më 31 mars t'i dorëzojnë rregullatorit të dhëna për strukturën e pronësisë, redaktorin përgjegjës dhe veprimtarinë ekonomike të vitit të kaluar, dhe të paktën tre herë gjatë vitit të programit të tyre, të publikojnë të dhëna për strukturën e pronësisë, redaktorin përgjegjës dhe burimet e financimit të një viti më parë.

Qëllimet: Rritja e transparencës së structures së pronësisë, redaksisë dhe financimit të transmetuesve.

Aktivitetet:

✚ Mbikëqyrja administrative mbi funksionimin e transmetuesve

Periudha e realizimit: Gjatë vitit

Rezultati: Raportet me shkrim nga mbikëqyrjet administrative të kryera

1.4. MBROJTJA E PLURALIZMIT TË PRONËSISË SË TRANSMETUESËVE

Agjencia do të monitorojë pronësinë e transmetuesve në aspektin e respektimit të dispozitave të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, të cilat kanë të bëjnë me kufizimet në fitimin e pronës, ndalimet e veçanta për fitimin e pronës dhe parandalimin e përqendrimit të paautorizuar mediatik. Gjithashtu do të veprojë sipas njoftimeve të dorëzuara për ndryshim të strukturës së pronësisë, do të shqyrtojë nëse ndryshimet e planifikuara do të shkelnin dispozitat e Kreut IV të Ligjit - „Mbrojtja e pluralizmit dhe diversitetit të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale“ dhe bazuar në informacionet e marra nga ekzaminimet do të marrin vendime që miratojnë ose ndalojnë zbatimin e ndryshimeve të planifikuara. Përveç kësaj, Agjencia do të kontrollojë nëse ndonjëri nga transmetuesit ka ndryshuar strukturën e pronësisë pa e njoftuar paraprakisht Agjencinë.

Qëllimi: Sigurimi i pluralizmit të pronës së transmetuesve.

Aktivitetet:

- † **Veprim sipas njoftimeve të dorëzuara për ndryshimin e strukturës së pronësisë së transmetuesve**

Periudha e realizimit: Gjatë vitit

Rezultati: Vendime për miratimin ose ndalimin e një ndryshimi në strukturën e pronësisë

- † **Përcjellja e structures së pronësisë së transmetuesve**

Periudha e realizimit: Gjatë tërë vitit

Rezultati: Njoftimet nga mbikëqyrjet e kryera; procedura të inicuar për konstatimin e përqendrimit të paautorizuar mediatik, përkatësisht shkelje të ndalesës nga nenet 34, 35 и 38 të Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale; raportet me shkrim nga mbikëqyrjet administrative të kryera

- † **Përgatitja e një raporti vjetor për pronësinë e medias (përshkrimi i pronësisë së medias, ndryshimet në strukturën e pronësisë dhe konstatimi i koncentrimin të paligjshëm të medias në mesin e transmetuesve)**

Periudha e realizimit: Gjysma e pare e vitit 2022

Rezultati: Raport i përgatitur për pronësinë e medias

1.5. MBIKËQYERJE PROFESIONALE

Agjencia do të kryejë mbikëqyrje profesionale të transmetuesve që do të pajisen me licencë të re për transmetim televiziv ose radio emetim si dhe të transmetuesve që do të ndryshojnë vendndodhjen e ambienteve ku prodhohet programi ose do ta zgjerojnë atë me ambiente të reja studioje.

Qëllimi: Plotësimi i kushteve teknike për kryerjen e veprimtarisë.

Aktivitetet:

† Mbikëqyerja profesionale e transmetuesve

Periudha e realizimit: Pas dhënies së licencës për transmetim radioteleviziv, si dhe gjatë ndryshimit të vendndodhjes së ambienteve ku prodhohet programi (studio) ose kur zgjerohet me ambiente të reja studimi

Rezultati: Procesverbale nga mbikëqyerjet e kryera profesionale

2. PËRFSHIRJA SHOQËRORE DHE ARSIMIMI MEDIATIK

Aktivitetet e Agjencisë për nxitjen e arsimimit mediatik në vitin 2022, në përputhje me detyrimet ligjore do të realizohen përmes bashkëpunimit me sektorin civil, institucionet arsimore dhe të gjitha palët e tjera të interesuara. Do të vazhdojë mbështetja e Rrjetit maqedonas për arsimim mediatik, kurse Agjencia do të mbetet aktive në nivel ndërkombëtar. Të gjitha aktivitetet do të synojnë ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e arsimimit mediatik në shoqërinë informative në të cilën jetojmë dhe zhvillimin e kompetencave të qytetarëve të Maqedonisë për arsimim mediatik. Agjencia do të vazhdojë të mbështesë aktivitetet për përfshirjen e arsimimit mediatik në arsim.

Agjencia gjithashtu do të këmbëngul që të motivojë transmetuesit e shërbimeve mediatike audiovizuale sipas kërkesës për t'i bërë programet e tyre/përmbajtje të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara shqisore.

Qëllimi: Disponueshmëri më e madhe e programeve të ofruesve të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale për personat me aftësi të kufizuara shqisore dhe nivel më i lartë i arsimimit mediatik tek qytetarët e Maqedonisë.

Aktivitetet:

† Mbështetje e Rrjetit për arsimim mediatik

Periudha e realizimit: Gjatë vitit

Rezultati: Takimet e realizuara të rrjetit dhe projektet e realizuara; redaktimi, përditësimi dhe mirëmbajtja e faqes së internetit të arsimimit mediatik; dhe koordinimi i komunikimit elektronik në Rrjet

† Organizimi i Ditëve të arsimimit mediatik 2022

Periudha e realizimit: Në gjysmën e dytë të vitit

Rezultati: Të mbajtura Ditët e arsimimit mediatik 2022

† Ngritja e ndërgjegjësimit tek publiku për rëndësinë e arsimimit mediatik

Periudha e realizimit: gjatë vitit – sipas nevojës

Rezultati: Material i përgatitur propagandistik dhe aktivitetet e kryera

† Inkurajimi i ofruesve të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale për t'i bërë programet/përmbajtjet e tyre të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara shqisore

Periudha e realizimit: Gjatë vitit

Rezultati: Takimet e mbajtura dhe aktivitetet e realizuara

3. INKURAJIMI I LIRISË SË SHPREHJES DHE LIRISË SË MEDIAVE

Në kontekst të inkurajimit të lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave, në vitin 2022 do të vazhdojnë aktivitetet që synojnë forcimin e kulturës redaktuese, pavarësinë e politikës editoriale dhe ndërgjegjësimin për rëndësinë e respektimit të standardeve profesionale tek profesionistët e mediave.

Qëllimi: Rritja e lirisë së shprehjes dhe lirisë së mediave

Aktivitetet:

- † **Organizimi dhe mbështetja e aktiviteteve të ndryshme që synojnë përmirësimin e respektimit të standardeve profesionale për kreyerjen e veprimtarisë transmetuese**

Periudha e realizimit: Gjatë vitit

Rezultati: Ngjarjet e mbajtura, ofrohet një lloj tjetër mbështetjeje

- † **Prezantim dhe debat mbi rezultatet e analizës së çështjeve gjinore dhe mënyrën e paraqitjes dhe përfaqësimit të grave dhe burrave në programet e transmetuesve**

Periudha e realizimit: Gjatë vitit

Rezultatet: Ngjarjet e mbajtura

4. DHËNIA E LICENCAVE PËR TELEVISION OSE RADIO TRANSMETUES

Sipas detyrës zyrtare ose pas pranimit të kërkesës me shkrim nga pala e interesuar, dhe nëse në përputhje me planin për ndarjen dhe shrytëzimin e radiofrekuencave ose me planin për qëllimin dhe shpërndarjen e kapaciteteve të multipleksit dixhital tokësor konstatohet se ekzistojnë radiofrekuenca të lira ose kapacitete, dhe nëse një studim i përgatitur më parë ka gjetur se ka një justifikim për dhënien e një licence të re për transmetim televiziv ose radio, Agjencia do të shpallë konkurs publik për dhënien e licencave për transmetim televiziv apo radio në nivel lokal, rajonal apo shtetëror, përveç kësaj, me kërkesë të palëve të interesuara, Agjencia do të japë licenca për transmetim televiziv dhe radio përmes rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk përdor resurse të kufizuara ose nëpërmjet satelitit, në mënyrën dhe procedurën e përcaktuar në Ligjin për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale.

Qëllimi: Rritja e cilësisë së përmbajtjes televizive dhe radios të disponueshme për publikun, si dhe duke i mundësuar publikut të aksesojë më shumë informacion nga burime të ndryshme.

Aktiviteti:

- † **Dhënia e licencave të transmetimit televiziv ose radio për shërbime programore të transmetuara mbi resurse të kufizuara (radiofrekuenca ose kapacitet transmetimi dixhital tokësor multipleks), përmes konkursit publik, dhe për shërbime programore të transmetuara përmes rrjetit publik të komunikimeve elektronike që nuk përdor resurse të kufizuara ose nëpërmjet satelitit, pa shpallur konkurs publik**

Periudha e realizimit: Sipas nevojës gjatë tërë vitit, edhe atë sipas detyrës zyrtare ose pas marrjes së një kërkesë me shkrim nga pala e interesuar

Rezultati: Licenca të dhëna për transmetim për transmetim televiziv ose radio

5. MBIKËQYRJE MBI OFRUESIT E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIOVIZUELE SIPAS KËRKESËS

Në përputhje me kompetencën e saj ligjore, Agjencia sipas kërkesës do t'i regjistrojë në regjistrin e ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele dhe do t'u lëshojë certikatë regjistrimi atyre subjekteve që në vitin 2022 do të paraqesin kërkesë për regjistrim.

Agjencia do të mbikëqyrë funksionimin e këtyre subjekteve, për të konstatuar nëse ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës i përmbushin detyrimet e përcaktuar në Ligj, të cilat kanë të bëjnë me:

- ✦ transferimi i veprave kinomatografike në periudhën e përcaktuar në marrëveshjet me poseduesit e të drejtave;
- ✦ mbrojtjen e të miturve;
- ✦ përdorimi i gjuhës dhe
- ✦ promovimi i prodhimit dhe aksesit në veprat audiovizuele evropiane.

Pas një përlllogaritjeje paraprake të kompensimit vjetor të mbikëqyrjes dhe faturës së dorëzuar tek ofruesit e shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës, Agjencia do të përcjellë përmbushjen e detyrimit për kompensimin e tij.

Qëllimi: Ofrimi i shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës me dispozitat ligjore.

Aktivitetet:

✦ **Lëshimi i vërtetimeve për regjistrimin në regjistrin e ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës**

Periudha e realizimit: Gjatë tërë vitit, pas dorëzimit të kërkesave për regjistrim në regjistrin e ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës

Rezultati: Certifikatat e regjistrimit të lëshuara në regjistrin e ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës

✦ **Mbikëqyrja mbi punën e ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës**

Periudha e realizimit: Gjatë tërë vitit

Rezultati: Raporte me shkrim nga mbikëqyrjet e kryera programore

† Llogaritja e kompensimit vjetor, përgatitja dhe dorëzimi i vendimeve dhe faturave si dhe përcjellja e kompensimit vjetor të mbikëqyrjes

Periudha e realizimit: Gjatë tërë vitit

Rezultati: Përgatitur dhe dorëzuar vendimet dhe faturat e kompensimit vjetor të mbikëqyrjes

6. MBIKËQYRJE E OPERATORËVE TË RRJETEVE PUBLIKE TË KOMUNIKIMIT ELEKTRONIK

Agjencia do të evidentojë në regjistrin e operatorëve që ritransmetojnë paketa programore ato subjekte që në vitin 2022 do të paraqesin kërkesë për regjistrim. Përveç kësaj, Agjencia do të lëshojë certifikata për regjistrimin e shërbimeve programore që do të ritransmetojnë, në bazë së kërkesës dorëzuar më parë dhe të drejtave autoriale dhe të drejtave të ndërlidhura. Për të siguruar që funksionimi i operatorëve të rrjeteve publike të komunikimeve elektronike të jetë në përputhje me dispozitat e Ligjit për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale, Agjencia do të kryej mbikëqyrje programore mbi funksionimin e tyre, të rregullt – në përputhje me afatet e përcaktuara në Planin vjetor të mbikëqyrjes së programit, Të jashtëzakonshme- në bazë të nismës së paraqitur nga organet shtetërore, persona juridikë ose fizikë, si dhe në rast dyshimi sipas detyrës zyrtare të Agjencisë dhe kontrollit-pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktin individual. Mbikëqyrja do t'i referohet përbushjes së detyrimeve të mëposhtme:

- ✦ regjistrimi paraprak i shërbimeve programore që i ritransmetojnë ,
- ✦ mbrojtjen e të miturve,
- ✦ përdorimi i gjuhës,
- ✦ ritransmetimi i shërbimeve programore të transmetuesve vendas vetëm në zonën e shërbimit për të cilën transmetuesi ka licencë transmetim, dhe
- ✦ obligimet shtesë për ata janë të përcaktuara në Ligjin për shërbimet mediatike audio dhe audiovizuale.

Pas përllogaritjes paraprake të kompensimit vjetor për mbikëqyrje dhe fatur të dorëzuar tek operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, Agjencia do të përcjellë përbushjen e obligimit për pagesën e këtij kompensimi.

Qëllimi: Ritransmetimi i shërbimeve programore në përputhje me dispozitat ligjore.

Aktivitetet:

- † **Evidentimi në regjistrin e operatorëve që ritransmetojnë paketat programore dhe I certifikatave për regjistrimin e paket shërbimeve programore pas kontrollit paraprak për rregullsinë dhe kompletimin e kërkesës së paraqitur.**

Periudha e realizimit: Gjatë tërë vitit, pas dorëzimit së kërkesave për evidentim në regjistrin e operatorëve që ritransmetojnë shërbime programore dhe për regjistrim paket shërbimesh programore

Rezultati: Certifikata të lëshuara për regjistrimin e paket shërbimesh programore

- † **Mbikëqyrja e programit mbi punën e operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik**

Periudha e realizimit: Gjatë tërë vitit

Rezultati: Raporte me shkrim nga mbikëqyerjet e kryera programore

- † **Llogaritja e kompensimit vjetor, përgatitja dhe dorëzimi i vendimeve dhe faturave si dhe përcjellja e arkëtimit të kompensimit vjetor të mbikëqyrjes**

Periudha e realizimit: Gjatë tërë vitit

Rezultati: Vendimet dhe faturat e përgatitura për kompensimin vjetor të mbikëqyrjes

7. MBIKËQYRJE MBI BOTUESIT E MEDIAVE TË SHKRUARA

Përbushja e obligimeve të botuesve të mediave të shkruara të përcaktuara në Ligjin për media, të cilat kanë të bëjnë me mbrojtjen e të miturve, emrimin e radaktorit përgjegjës , publikimin e ipresiumit dhe transparenca në punë, Agjencioni do ta përcjellë përmes mbikëqyrjes administrative. Mbikëqyerjet e rregullta mbi përbushjen e dy obligimeve të fundit Agjencia do t'i zbatoj brenda afateve të përcaktuara në Planin vjetor për kryejën e mbikëqyrjes administrative në vitin 2022, ndërsa përbushja e obligimeve tjera do t'i nënshtrohen mbikëqyrjes së jashtëzakonshme.

Qëllimet: Përmbushja e obligimeve e botuesve të mediave të shkruara.

Aktivitet:

✚ **Mbikëqyerja administrative mbi punën e botuesve të mediave të shkruara**

Periudha e realizimit: Gjatë tërë vitit

Rezultati: Raporte me shkrim nga mbikëqyerjet administrative të kryera

8. ANALIZA DHE HULUMTIME

Në vitin 2022 Agjencia do të vazhdojë të kryejë hulumtime dhe analiza që ofrojnë të dhëna relevante të rëndësishme për politikëbërjen dhe implementimin e kompetencave ligjore. Për të siguruar të dhëna të sakta dhe gjithëpërfshirëse mbi ecurinë ekonomike të transmetuesve dhe numrin dhe strukturën e të punësuarve tek transmetuesit, Agjencia do të kryej dy analiza në tremujorin e tretë-Analizën e Tregut të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele për vitin 2021 dhe strukturën e të punësuarve në industrin e mediave audio dhe audiovizuele në vitin 2021. Agjencia edhe gjatë vitit 2022 do të vazhdojë të bëjë analiza për çështjet gjinore dhe mënyrën e paraqitjes dhe përfaqësimit të grave dhe burrave në programet e transmetuesve në përputhje me obligimet e Ligjit për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat. Aktivitetet në lidhje me sigurimin e të dhënave të sakta për shikueshmërinë e shërbimeve programore televizive dhe dëgjimin e radio stacioneve do të vazhdojë edhe në vitin 2022. Të dhënat e këtitilla Agjencia do t'i siguroj nga agjencia e specializuar kërkimore, e përzgjedhur në përputhje me Ligjin për furnizim publik. Në gjysmën e dytë të vitit, Agjencia do të përgatisë një Analizë për zhvillimin e transmetimit në mjedisin e ri dixhital, qëllimi i të cilit është të pasqyrojë gjendjen aktuale të transmetimit në Maqedoni, dhe më pas për të dhënë drejtimet e mundshme për zhvillimin e tij me të rejat e pritshme teknologjike në fushën produksionit të përmbajtjes në fushën e transmetimit. Në fushën e produksionit të përmbajtjes, pritshmëritë nga analiza janë të tregojë tendencën e prodhimit të përmbajtjes me përdorimin e pajisjeve dixhitale, krijimni e mjediseve virtuale dhe braktisjen graduale të përdorimit të studiove klasike. Për sa i përket transmetimit, analiza pritet të identifikojë impaktin e teknologjive të reja të informacionit dhe komunikimit siç është 5G, aplikimi i të cilit pritet të ndryshojë mënyrën e marrjes dhe shikimit të përmbajtjes.

Qëllimi: Hartimi i situatës në industri, sigurimi i të dhënave relevante që përdoren në politikëbërjen dhe zbatimin e kompetencave ligjore, sigurimi i të dhënave për pikëpamjet dhe

opinionet e publikut në lidhje me përmbajtjen e radios dhe televizionit, si dhe ofrimi i të dhënave relevante për shikueshmërinë e televizionit dhe për dëgjueshmërinë e radios.

Aktivitetet:

- ✚ **Mbledhja, përpunimi dhe analiza e të dhënave për performansat ekonomike të transmetuesve**

Periudha e realizimit: Tremujori I tretë I vitit 2022

Rezultati: Analizë e përgatitur e tregut të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele për vitin 2021

- ✚ **Analiza e numrit dhe strukturës të punësuarëve në stacione televizive dhe radio stacione në vitin 2021**

Periudha e realizimit: Tremujori I tretë I vitit 2022

Rezultati: Struktura e krijuar e të punësuarëve në industrinë e mediave audio dhe audiovizuele në vitin 2021

- ✚ **Analiza e çështjeve gjinore dhe mënyra e paraqitjes dhe prezantimit të grave dhe burrave në programet e transmetuesve**

Periudha e realizimit: Në gjysmën e parë të vitit 2022

Rezultatet: Raporti i përgatitur

- ✚ **Sondazhi i opinionit publik për pikëpamjet dhe opinionet e audiencës në lidhje me përmbajtjet radiotelevizive, nevojat e përmbajtjes shtesë dhe shkallën e kënaqësisë me ofertën programore**

Periudha e realizimit: Në gjysmën e dytë të vitit

Rezultati: Hulmtimi i kryer dhe raporti i përgatitur

- ✚ **Implementimi i hulumtimeve kuartale që të sigurohen të dhëna për dëgjueshmërinë e radios dhe shikueshmërinë e kanaleve televizive të cilat nuk janë përfshirë me matje elektronike**

Periudha e realizimit: Çdo kuartal të vitit

Rezultatet: Raportet nga hulumtimet e kryera kuartale dhe raporti vjetor mbi arritjet e radistacioneve dhe pjesëmarrja në shikueshmërinë totale kanaleve televizive

✚ **Analiza e zhvillimit të transmetimit në mjedisin e ri dixhital**

Periudha e realizimit: Në gjysmën e dytë të vitit

Rezultatet: Analiza e përgatitur

9. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Agjencia do ta realizojë bashkëpunimin ndërkombëtar përmes pjesëmarrjes në takimet e rregullta të Platformës Evropiane të organeve rregullatore (EPRA), Grupit të rregullatorëve Evropian për shërbime mediatike audiovizuale (ERGA), Rrjeti Mesdhetar i organeve rregullatore (MNRA), në ngjarje të tjera relevante audiovizuale ndërkombëtare, si dhe duke thëlluar bashkëpunimin bilateral me organet rregullatore në Evropë dhe veçanërisht në rajon. Njëkohësisht do të vazhdojë bashkëpunimin me misionin e OSBE-së në Shkup, Këshillin e Evropës dhe BE-në dhe do të marrë pjesë në procesin e rishikimit Universal periodik të Këshillit të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut.

Qëllimi: Shkëmbimi i informacionit, përvojave dhe praktikave të mira me organet rregullatore audiovizuale për çështje që lidhen me implementimin e legjislacionit të medias dhe pjesëmarrjen e Agjencisë në aktivitetet ndërkombëtare që kanë të bëjnë me nxitjen e lirisë së shprehjes, lirisë së media, si dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm për media.

Aktivitetet:

✚ **Pjesëmarrja në punën e asociacioneve të organeve rregullatore në fushën audiovizuale : Platforma Evropiane e organeve rregullatore (EPRA), rrjeti mesdhetar i organeve rregullatore (MNRA), Grupi Evropian i rregullatorëve e shërbimeve mediatike audiovizuale (ERGA), ngjarjet ndërkombëtare relevante në fushën audiovizuale, realizimi i bashkëpunimit dhe takimeve bilaterale me organet rregullatore në Evropë, veçanërisht me organet rregullatore rajonale**

Periudha e realizimit: Gjatë tërë vitit

Rezultati: Përvojat e shkëmbyera dhe të fituara dhe informimi nëpërmjet pjesëmarrjes në takimet për çështjet që dalin nga fusha audiovizuale, protokole të nënshkuara dhe memorandumet e bashkëpunimit

- † **Bashkëpunimi me misionin e OSBE-së në Shkup, Përfaqësuesin e OSBE-së për lirinë e medias, dhe OSBE/ODIHR dhe organe të tjera ndërkombëtare, aktivitetet e të cilave kanë të bëjnë me përcjelljen e mbulimit mediatik gjatë fushatës zgjedhore**

Periudha e realizimit: Gjatë tërë vitit

Rezultati: Vazhdimësia në implementimin e parimeve që përmbajnë dokumentet e organeve përkatëse ndërkombëtare që kanë të bëjnë me monitorimin e zgjedhjeve

- † **Bashkëpunimi me Këshillin e Evropës dhe BE-në për të forcuar lirinë e shprehjes dhe medias në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës në kuadër të projektit JUFREX2**

Periudha e realizimit: Gjatë tërë vitit

Резултат: Rritja e kapaciteteve institucionale të Agjencisë përmes pjesëmarrjes në punëtori, trajnime, bërja e studimeve, si dhe shkëmbim informacioni dhe përvojash për çështje të fushës së mediave audiovizuale.

- † **Pjesëmarrja në procesin e rishikimit periodik Universal të Këshillit të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e njeriut**

Periudha e realizimit: Gjatë tërë vitit

Rezultati: Kontributi i Agjencisë në Raportin Nacional të Republikës së Maqedonisë së Veriut pas rishikimit Universal Periodik të Këshillit për të drejta e njeriut të OKB-së; pjesëmarrja në Organin Ndërsektorial për të drejtat e njeriut

10. PROCESI I INTEGRIMIT EVROPIAN

Kontributin e Agjencisë në procesin e integritimeve evropiane të Republikës së Maqedonisë së Veriut do ta realizojë duke marrë pjesë në procesin e përgatitjes dhe implementimit të Progarmit nacional për miratimin e legjislacionit evropian (NPAA), pjesëmarrjen në grupet punuese dhe organet tjera relevante për veprimtarinë audiovizuale. Agjencia gjithashtu do të përcjellë në vazhdimësi mundësitë për shrytëzimin e mjeteve financiare nga instrumenti IPA.

Qëllimi: Pjesëmarrja e Agjencisë në procesin e integritimeve evropiane të Republikës së Maqedonisë së Veriut, në fushën audiovizuale Учество на Агенцијата во процесот на европска интеграција на Република Северна Македонија, во аудиовизуелната област.

Aktivitet:

- ✚ **Pjesëmarrja në përgatitjen dhe implementimin e revizionit të Programit kombëtar për miratimin e legjislacionit evropian NPAA 2021-2023-2025 dhe në grupet e punës relevante për fushën audiovizuale**

Periudha e realizimit: Gjatë tërë vitit

Rezultatet: Kontributi i përgatitur nga Agjencia për përgatitje e NPAA 2021-2023-2025; raporte të përgatitura për implementimin e tij; takimet e mbajtura në kuadër të grupeve të punës në Kapitullin 1. Kriteret politike; 3.7 Të drejtat e pronësisë intelektuale; 3.8 Politika e konkurrencës; 3.10 Shoqëria e informacionit dhe media; dhe 3.23 Gjyqësori dhe të drejtat themelore

- ✚ **Përgatitja e raporteve dhe informacioneve relevante për procesin e integritit evropian dhe pjesëmarrja në trupat punuese që ofrojnë dialog me Komisionin Evropian në fushën audiovizuale**

Periudha e realizimit: Gjatë tërë vitit

Rezultati: Raporte të përgatitura për kontributin në Raportin e progresit të Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut; realizimi i pjesëmarrjes në trupat punuese në procesin e integritimeve evropiane ndërmjet Komisionit Evropian dhe Republikës së Maqedonisë së Veriut, Komitetit për Stabilizim dhe Asociim, Nënkomiteti për inovacion, shoqëri informative dhe politikë sociale dhe Nënkomiteti për drejtësi, liri dhe siguri, Komiteti punues për integritime evropiane dhe Nënkomiteti për Komunitetin punues për Integritime Evropiane

11. TRANSPARENCA NË PUNË DHE KOMUNIKIMI ME PUBLIKUN

Për të siguruar transparencë në punën e saj, Agjencia në vitin 2022 do të organizojë takime publike ku do të informojë publikun dhe mediat për aktivitetet e realizuara. Njëkohësisht, temat aktuale në fushën audiovizuale do të trajtohen në takimet publike përmes prezantimeve dhe diskutimeve. Transparencë në punë e saj, Agjencia do të sigurojë duke përditësuar rregullisht

ueb faqen e saj në maqedonisht, shqip dhe anglisht, duke e bërë atë të aksesueshme për një numër sa më të madh të qytetarëve.

Në kanalin e saj YouTube, Agjencia do të sigurojë rregullisht regjistrime të trajnimeve, punëtorive, takimeve publike dhe aktiviteteve të tjera. Komunikimin me publikun Agjencia do ta realizojë përmes komunikatave për shtyp, konferenca për shtyp, deklarata për media dhe të tjera.

Qëllimi: Sigurimi i transparencës më të madhe në punën e Agjencisë dhe komunikimi me efikas me publikun.

Aktivitetet:

✚ Organizimi i takimeve publike të Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale

Periudha e realizimit: Njëherë në çdo tre muaj

Rezultati: Mundësi e ofruar për të gjithë të interesuarit që të njihen me aktivitetet e realizuara të Agjencisë në përputhje me Programin vjetor të punës dhe të shprehin mendimet dhe qëndrimet e tyre në lidhje me zhvillimin e shërbimeve audio dhe audiovizuale, veçanërisht situatën e tregut të mediave për shërbimet audio dhe audiovizuale.

✚ Komunikimi me publikun

Periudha e realizimit: Gjatë tërë vitit

Rezultati: Komunikata të dërguara për shtyp, konferenca të mbajtura për shtyp, deklarata të dhëna për mediat

✚ Përditësimi i rregullt i ueb faqes së Agjencisë në maqedonisht, shqip dhe anglisht

Periudha e realizimit: Gjatë tërë vitit

Rezultati: Uebfaqja e përditësuar dhe informacione të disponueshme për të gjitha palët e interesuara mbi aktivitetet e Agjencisë

✚ Veprimi sipas kërkesave që dalin nga Ligji për qasje të lirë tek informatat të karakterit publik dhe përditësimi i listës së informative të karakterit publik

Periudha e realizimit: Gjatë tërë vitit

Rezultati: Përgjigja ndaj kërkesave të parashtruara për qasje tek informata me karakter publik dhe publikimi i tyre në ueb faqen e Agjencisë; lista e përditësuar me informacione të karakterit publik

✚ **Publikimi dhe distribuimi i botimeve, broshurave, dhe të ngjajshme, me tema në sferën mediatike**

Periudha e realizimit: Nëse është e nevojshme, gjatë tërë vitit

Rezultati: Botime, broshura, fletëpalosje dhe të ngjajshme shtypen dhe shpërndahen për të gjitha subjektet relevante dhe qytetarëve

✚ **Përditësimi i përmbajtjeve të kanalit YouTube të Agjencisë**

Periudha e realizimit: Gjatë tërë vitit

Rezultati: Postime e trajnimeve, punëtorive, takimeve publike dhe aktiviteteve të ngjajshme të Agjencisë në kanalin e saj në YouTube

12. RITJIA E KAPACITETEVE INSTITUCIONALE TË AGJENCISË

Agjencia do të ndërmarrë aktivitete lidhur me certifikimin e sistemit për udhëheqjen e cilësisë ISO 9001:2015.

Në vitin 2022, Agjencia do të fillojë me aktivitetet për vërjen e certifikates ISO 27001:2013 gjegjësisht sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit. Aktivitetet do të synojnë ofrimin e shërbimeve konsulente për vërjen e vet certifikatës duke zhvilluar procedura në përputhje me këtë standard. Aktivitetet do të përfundojnë me certifikimin e standardit të prezantuar.

Qëllimi: Sigurimi i punës së Agjencisë në përputhje me standardin e menaxhimit të cilësisë dhe ISO 9001:2015 dhe vërja e një sistemi të menaxhimit të sigurisë së informacionit

Aktivitetet:

✚ **Kontrollimi dhe rishikimi i procedurave ekzistuese ISO në Agjenci**

Periudha e realizimit: Gjatë tërë vitit

Rezultati: Procedurat e kontrolluara dhe rishikuara

✚ **Krijimi i procedurave të reja në përputhje me ISO 27001:2013**

Periudha e realizimit: Gjatë tërë vitit

Rezultati: Krijimi i procedurave në përputhje me ISO 27001:2013

13. REVIZIONI I BRENDSHËM NË AGJENCI

Në vitin 2022 do të kryhen tre revizione dhe ato: revizioni i sistemeve të menaxhimit të cilësisë-Kërkesat (ISO 9001:2015), revizioni i menaxhimit të burimeve njerëzore dhe revizioni financiar .

Qëllimi: Rritja e vlerës së Agjencisë dhe përmirësimi i punës së saj, duke ofruar siguri të arsyeshme dhe , nëse është e nevojshme, rekomandime për funksionimin e duhur të sistemeve të menaxhimit të cilësisë-Kërkesat (ISO 9001:2015), menaxhimin e burimeve njerëzore dhe përgatitjen e raportit financiar të Agjencisë gjatë 2022.

Aktivitetet:

† **Revizioni mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë-Kërkesat (ISO 9001:2015)**

Periudha e realizimit: Nga 1 janari deri më 28 prill 2022

Rezultati: Raporti i revizionit të kryer

† **Revizioni mbi menaxhimin e burimeve njerëzore**

Periudha e realizimit: nga 2 maji deri më 31 gusht 2022

Rezultati: Raporti i revizionit të kryer

† **Revizioni financiar**

Periudha e realizimit: nga 1 shtatori deri më 31 dhjetor 2022

Rezultati: Raporti i revizionit të kryer

**Agjencia për shërbime mediatike
audio dhe audiovizuale
Kryetar I Këshillit**

Lazo PETRUSHEVSKI

**01-4701/1
22.12.2021
Shkup**

PASQYRË E AKTIVITETEVE TË PLANIFIKUARA SIPAS SEKTORIT QË ËSHTË KOMPETENT PËR RALIZIMIN E TYRE DHE PERIUDHËN NË TË CILËN DUHET REALIZUAR

Nr.rend	Aktivitetet	Sektori kompetent	Periudha e realizimit
	Mbikëqyerja programore mbi programet e transmetuesve në përputhje me <i>Metodologjinë për kryerjen e mbikëqyerjes (monitorimit)</i>	Sektori për çështjet programore	Gjatë vitit
	Mbikëqyerja administrative mbi funksionimin e transmetuesve	Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit Sektori për çështjet programore Sektori I financave dhe logjistikës Sektori për mbështetje informatike dhe çështjet e përgjithshme	Gjatë vitit
	Veprimi pas dorëzimit të njoftimeve për ndryshimin e strukture së pronësisë së transmetuesve	Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit	Gjatë vitit
	Përcjellja e strukture së pronësisë së transmetuesve	Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit	Gjatë tërë vitit
	Përgatitja e raportit vjetor për pronësinë e medias	Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit	Gjysma e pare e vitit
	Mbështetje e Rrjetit për arsimim mediatik	Sektori për çështjet programore	Gjatë vitit
	Organizimi I Ditëve të arsimimit mediatik 2022	Sektori për çështjet programore	Në gjysmën e dytë të vitit
	Ngritja e ndërgjegjësimit të publikut për rëndësinë e arsimimit mediatik	Sektori për çështjet programore	Gjatë vitit – sipas nevojës
	Inkurajimi I ofruesve të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuale që t’i bëjnë programet /përmbajtjet e tyre të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara shqisore	Sektori për çështjet programore	Gjatë vitit
	Organizimi dhe mbështetja e aktiviteteve të ndryshme që synojnë përmirësimin e respektimit të standardeve profesionale për kryerjen e veprimtarisë transmetuese	Sektori për çështjet programore	Gjatë vitit

	Prezantim dhe debat mbi rezultatet e analizës së çështjeve gjinore dhe mënyrën e paraqitjes dhe përfaqësimit të grave dhe burrave në programet e transmetuesit	Sektori për çështjet programore	Gjatë vitit
	Mbikëqyerja profesionale e transmetuesve	Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit Sektori për mbështetje informatike dhe çështjet e përgjithshme	Pas dhënies së licencës për radio ose transmetim televiziv, si dhe gjatë ndryshimit të vendndodhjes

			Mjediset në të cilat prodhohet programi (studio) ose gjatë zgjerimit të studiove me ambiente të reja
	Dhënia e licencave për transmetim televiziv ose radio	Të gjithë sektorët	Sipas nevojës, gjatë tërë vitit, dhe atë sipas detyrës zyrtare ose pas marrjes së një kërkesë me shkrim nga pala e interesuar
	Lëshimi I vërtetimeve për regjistrim në regjistrin e ofruesve të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele sipas kërkesës	Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit	Gjatë tërë vitit, pas paraqitjes së kërkesave për evidentim në regjistrin e ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës
	Mbikëqyerja mbi punën e ofruesve të shërbimeve mediatike audio dhe audiovizuele sipas kërkesës	Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit	Gjatë tërë vitit
	Llogaritja e kompensimit vjetor, përgatitja dhe dorëzimi i vendimeve dhe përcjellja e pagesës së kompensimit vjetor për mbikëqyerjen e ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizuele sipas kërkesës dhe operatorëve publik të rrjeteve të komunikimit elektronik	Sektori I financave dhe logjistikës	Gjatë tërë vitit
	Evidentimi në regjistrin e operatorëve që ritransmetojnë paketa programore dhe lëshimi I vërtetimeve për regjistrimin e paketë shërbimeve programore pas kontrollit paraprak për rregullsinë dhe kompletimi I aplikacionit të paraqitur	Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit	Gjatë tërë vitit
	Mbikëqyerja programore mbi punën e operatorëve të rrjeteve publike të komunikimit elektronik	Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit	Gjatë tërë vitit

	Mbikëqyerja administrative mbi punën e botuesve të medias së shkruar	Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit	Gjatë tërë vitit
	Mbledhja, përpunimi dhe analiza e të dhënave për performancën ekonomike të transmetuesve	Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit	Kuartali I tretë I vitit
	Analiza e numrit dhe strukturës së të punësuarëve në stacionet televizive dhe radistacionet në vitin 2021	Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit	Kuartali I tretë I vitit
	Analiza e çështjeve gjinore dhe mënyra e paraqitjes dhe prezantimit të grave dhe burrave në programet e transmetuesve	Sektori për çështjet programore	Në gjysmën e parë të vitit 2022
	Hulumtimi I opinionit publik mbi pikëpamjet dhe opinionet e audiences në lidhje me përmbajtjen e radios dhe televizionit, nevojën për përmbajtje shtesë dhe	Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit	Në gjysmën e dytë të vitit

	Shkallën e kënaqësisë me ofertën e programit		
	Implementimi hulumtimeve kuartale për të siguruar të dhëna për dëgjueshmërinë e radios dhe shikueshmërinë e kanaleve televizive që nuk përshihen nga matja elektronike	Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit	Çdo kuartal të vitit
	Analizë e zhvillimit të transmetimit në mjedisin e ri dixhital	Sektori për mbështetje informatike dhe çështjet e përgjithshme	Në gjysmën e dytë të vitit
	Pjesëmarrja në punën e asociacioneve të organeve rregullatore në fushën audiovizuale: Platforma evropiane e organeve rregullatore (EPRA), Rrjeti Mesdhetar I organeve rregullatore (MNRA), Grupi I rregullatorëve evropian të shërbimeve mediatike audiovizuale (ERGA), në ngjarjet me karakter ndërkombëtare relevante në fushën audiovizuale, realizimi I bashkëpunimit dhe takime bilaterale me organet rregullatore në Evropë, veçanërisht me organet rregullatore rajonale	Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit	Gjatë tërë vitit
	Bashkëpunimi me Misionin e OSBE-së në Shkup, Përfaqësuesin për lirinë e medias të OSBE-së me OSBE/ODIHR dhe organe të tjera ndërkombëtare të përfshira në përcjelljen e prezantimit mediatik gjatë fushatës zgjedhore	Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit	Gjatë tërë vitit

	Bashkëpunimi me Këshillin e Evropës dhe BE-në për të forcuar lirinë e shprehjes dhe të medias në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës në kuadër të projekti JUFREX 2	Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit	Gjatë tërë vitit
	Pjesëmarrja në procesin e rishikimit periodik Universal të Këshillit të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e njeriut	Sektori për çështjet juridike	Gjatë tërë vitit
	Pjesëmarrja në përgatitjen dhe implementimin e Programit Kombëtar për miratimin e legjislacionit evropian - NPAA 2021-2023-2025 dhe në grupet e punës të ngritura për këtë qëllim	Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit Sektori për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit Sektori për çështjet juridike Sektori për mbështetje informatike dhe çështjet e përgjithshme	Gjatë tërë vitit
	Përgatitja e raporteve dhe informacioneve relevante për procesin e integritetit evropian dhe pjesëmarrja në trupat punues që ofrojnë dialog me Komisionin Evropian në fushën audiovizuale	Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit	Gjatë tërë vitit
	Organizimi i takimeve publike të	Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit	Njëherë në çdo tre muaj
	Agjencisë për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale	Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit	Gjatë tërë vitit
	Komunikimi me publikun	Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit	Gjatë tërë vitit
	Përditësimi i rregullt ueb faqes të Agjencisë në maqedonisht, shqip dhe anglisht	Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit	Gjatë tërë vitit
	Veprimi sipas kërkesave që dalin nga Ligji për Qasje të lire tek informatat me karakter publik dhe përditësimi i listës së informatave me karakter publik	Zyrtar për ndërmjetësim me informata të karakterit publik Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit	Gjatë tërë vitit
	Botimi dhe distribuimi i botimeve, broshurave dhe të ngjajshme, me tema në sferën mediatike	Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit	Sipas nevojës, gjatë tërë vitit
	Përditësimi i përmbajtjeve të kanalit të Agjencisë në YouTube	Sektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit	Gjatë tërë vitit
	Kontrollimi dhe rishikimi i procedurave ekzistuese ISO në Agjenci dhe përgatitja e procedurave të reja në përputhje me ISO 27001:2013	Të gjithë sektorët	Gjatë tërë vitit
	Revizioni i sitemeve të menaxhimit të cilësisë- Kërkesat (ISO 9001:2015)	Shërbimi i revizionit të brendshëm	Nga 1 janari deri më 28 prill 2022

	Revizioni mbi menaxhimin e resurseve njerëzore	Shërbimi I revizionit të brendshëm	Nga 2 maji deri më 31gusht 2022
	Revizioni financiar	Shërbimi I revizionit të brendshëm	Nga 1 shtatori deri më 31 dhjetor 2022